



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



# **Raport përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale të OSSH-së**

**Shqyrtimi i njëmbëdhjetë i Tarifave të Energjisë Elektrike**

**SHTE 11 (2017-2018)**

## **DEKLARATË**

**Ky Raport është përgatitur nga ZRRE me qëllim të informimit të palëve të interesit. Raporti nuk paraqet Vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të konsiderohet si i tillë.**

**Mars 2017**



## Përmbajtja

<b>1</b>	<b>Përmbledhje.....</b>	<b>3</b>
<b>2</b>	<b>Bilanci i energjisë dhe kostoja e humbjeve .....</b>	<b>3</b>
	Komenti i KEDS .....	3
	Përgjigja e ZRRE-së .....	3
<b>3</b>	<b>Kostot e personelit .....</b>	<b>4</b>
	Komenti i KEDS .....	4
	Përgjigja e ZRRE-së .....	4
<b>4</b>	<b>Komponentët tjerë .....</b>	<b>4</b>
	Komenti i KEDS .....	4
	Përgjigja e ZRRE-së .....	4
<b>5</b>	<b>Kostot e Përrjashtuara .....</b>	<b>5</b>
	Komenti i KEDS .....	5
	Përgjigja e ZRRE-së .....	5
<b>6</b>	<b>Përshtatjet për KREV .....</b>	<b>6</b>
	Komenti i KEDS .....	6
	Përgjigja e ZRRE-së .....	6
<b>7</b>	<b>Përmbledhja e të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH-së .....</b>	<b>7</b>



## **1 Përmbledhje**

Pas vlerësimit fillestar të aplikacioneve lidhur me të Hyrat e Lejuara Maksimale për të licencuarin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH, KEDS), i licencuari dhe palët tjera të interesit kanë pasur mundësi ti paraqesin komentet e tyre përmes konsultimit publik për periudhë dy javore.

Me qëllim të vlerësimit sa më të drejtë të të hyrave të lejuara maksimale për OSSH, përfaqësuesit e ZRRE-së dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes kanë pasur disa takime për të sqaruar kalkulimet në vlerësimin fillestar.

Ky dokument paraqet përgjigjet në komentet e bëra nga palët e interesuara, dhe qëndrimin përfundimtar të ZRRE-së lidhur me të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH-së.

Lidhur me vlerësimin fillestar të të hyrave të lejuara maksimale të OSSH-së, ZRRE nuk ka pranuar ndonjë koment nga ndonjë palë tjetër përveç komenteve të KEDS-it të cilat janë të përshkruara më poshtë:

## **2 Bilanci i energjisë dhe kostoja e humbjeve**

### **Komenti i KEDS**

KEDS është pajtuar me vlerësimin fillestar të ZRRE-së lidhur me volumet e energjisë si dhe nivelin shitjeve në OSSH ashtu siç e ka parashikuar KEDS në aplikacionin e tij.

KEDS deklaron se niveli i parashikuar i zvogëlimit të humbjeve të trashëguara nga viti 2013, të shkaktuara nga nën-performanca e mbajtësit paraprak të licencës nuk duhet aplikuar gjatë llogaritjes së bilancit të energjisë, respektivisht edhe gjatë kalkulimit të kostove të humbjeve. KEDS thekson se ndëshkimi prej 1.8% të nivelit të humbjeve në vazhdimësi është duke e bartur padrejtësisht tek KEDS.

### **Përgjigja e ZRRE-së**

ZRRE-ja pranon faktin që KEK nuk ka qenë i suksesshëm në arritjen e caktuar të humbjeve para se të barten përgjegjësitë tek KEDS. ZRRE tashmë ka dhënë një përgjigje të detajuar mbi këtë çështje në SHTE8 (Raporti Konsultativ - llogaritja e MAR të OSSH-së) i publikuar me 24 qershor 2014, dhe konfirmon se qëndrimi i ZRRE-së për këtë çështje nuk ka ndryshuar dhe se dallimi në ndërmjet të humbjeve të lejuara dhe realizuara duhet të bartet nga OSSH-ja në mënyrë që të sigurohet një nxitje për uljen e humbjeve në nivelin e caktuar nga ZRRE, në mënyrë që OSSH të përfitoj nga arritja e caktuar të humbjeve, në të kundërtën mos arritja e këtij caku do të jetë barrë e OSSH-së.



### **3 Kostot e personelit**

#### **Komenti i KEDS**

OSSH ka kërkuar nga ZRRE të konsideroj një rritje prej 5% në paga për punëtorët e tij për vitin 2017, të vlerësuara nga KEDS-i në vlerë 0.81 milion euro. Përveç, rritjes së kostos së pagave, KEDS ka përfshi në kalkulimet e tij edhe kostot shtesë të sigurimit shëndetësor i cili pritet të aplikohet nga muaji korrik i vitit 2017. Të dyja këto shpenzime kanë një ndikim në kostot e personelit për OSSH-në në vlerë prej 0.9 milion euro shtesë.

#### **Përgjigja e ZRRE-së**

Rregullat e çmimeve përcaktojnë se nivelet e lejuara të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes (OPMct) janë të caktuara gjatë shqyrtimeve periodike dhe mbesin të pandryshuara përgjatë periudhës rregullative. Duhet pasur parasysh se niveli i realizuar i OPEX-it për periudhën 2013-2015 është më i ultë se niveli i lejuar nga ZRRE, andaj konsiderojmë se ka mjete të mjaftueshme për këtë kategori të shpenzimeve. Në rast se KEDS detyrohet të bëjë shpenzime shtesë të cilat janë jashtë kontrollit të saj ZRRE do ti konsiderojë ato.

### **4 Komponentët tjerë**

#### **Komenti i KEDS**

Që nga muaji mars i vitit 2017, OSSH si pjesë e sistemit balancues do të jetë përgjegjëse për çdo devijim të humbjeve të parashikuara, të cilat kosto nuk janë parashikuara nga ZRRE-ja.

OSSH beson se do të vazhdojë blerjen e humbjeve nga KESCO si FSHU të paktën për Furnizuesin e Shërbimit Universal, bazuar në kostot e përbëra të blerjeve të FSHU, e cila do të ndikoj në reduktimin e shpenzimeve, respektivisht kjo do të parandalojë rritjen e tarifave për përdoruesit fundorë me zbatimin e menjëhershëm të të gjitha këtyre ndryshimeve tarifore. Derisa sistemi SCADA të zbatohet, e cila do të lejojë matje të tilla, OSSH dhe FSHU duhet të mbeten në të njëjtin grup të balancimit, siç është praktikë në shumë vende të zhvilluara, duke përfshirë edhe ato të cilat janë anëtare të Bashkimit Evropian, të tilla si Bullgaria.

#### **Përgjigja e ZRRE-së**

Bazuar në legjislacionin primar dhe sekondar, OSSH duhet të bëjë blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, si dhe blerjen dhe shitjen e energjisë së balancimit. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të sigurojë energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve në



rrjetin e shpërndarjes dhe për shërbimet ndihmëse në rrjetin e shpërndarjes, sipas parimeve të tregut të energjisë elektrike, transparencës dhe jodiskriminimit. Andaj ZRRE i ka lejuar në kostot e humbjeve nivelin e lejuar të humbjeve që caktohet gjatë shqyrtimeve periodike të parashikuara në MAR që do të mbulohet nga OSSH-ja për të kompensuar humbjet në sistemin e shpërndarjes. Madje ZRRE ka lejuar OSSH-së edhe kostot që kanë të bëjnë me obligimet ndaj KOSTT-it për shërbimet e Operatorit të Sistemit dhe Operatorit të Tregut.

## **5 Kostot e Përrjashtuara**

### **Komenti i KEDS**

Në kuadër të rishikimit të kostove të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nga ana e ZRRE-së, OSSH-së ka vënë re se kostot që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve të përjashtuara janë zbritur tërësisht gjatë përcaktimit të kostove të lejuara për tre vitet në vijim, përkatësisht përshtatjet për vitet 2013 dhe 2014 janë aplikuar edhe në këtë vit, së bashku me ato të vitit 2016.

OSSH beson se përshtatjet e tilla, nëse është e nevojshme, duhen të bëhen në fund të periudhës rregullative së bashku me përshtatjet e tjera.

KEDS pajtohet me uljen e kostove të përjashtuara për vitin 2016, ndërkohë përshtatjet për vitin 2013 dhe 2014 duhet të zbatohet në fund të periudhës rregullative.

### **Përgjigja e ZRRE-së**

Në bazë të rregullave për përcaktimin e të hyrave, ZRRE do të bëjë përshtatjet e rregullta të hyrave për çfarëdo e hyre të parregulluar (të hyrat nga dhënia me qira e aseteve, të hyrat nga operatorët e ndryshëm ekonomik, shitja e aseteve, shërbimet e ndryshme ndaj konsumatorëve, etj).

Duke qenë se ky vit tarifor është i fundit për këtë periudhë rregullative, dhe se në vitet në vijim pritet hapja e tregut të energjisë elektrike edhe për konsumatorët e kyçur në nivel të OSSH-së, dhe duke qenë se këta konsumatorë paraprakisht kanë qenë të ngarkuar me këto kosto duhet që edhe në mënyrë të njejtë të bartin përfitim nga këto të hyra të parregulluara të realizuara nga OSSH.

Vlera përfundimtare e kostove të përjashtuara (të hyrat e parregullara) në MAR-in final të OSSH do të reduktohet në vlerën prej 5.9 milion euro.



## 6 Përshtatjet për KREV

### Komenti i KEDS

Në vlerësimin e të hyrave të lejuara maksimale për OSSH-në, ZRRE ka zbritur në total të hyrat që kanë të bëjnë me energjinë e pa-faturuar dhe rikthimin e humbjeve. Lidhur me këtë çështje, siç theksohet në aplikimin për MAR, bazuar në raportet e arkëtimit të pranuar nga OSSH, jo e gjithë sasia e energjisë e faturuar si “rikthimi i humbjeve” arkëtohet nga konsumatorët të cilëve i është lëshuar fatura për rikthimin e humbjeve për faktin se:

1. Konsumatorët mund të ankohen në instance të parë në ZRRE dhe më pastaj edhe në gjykatë, andaj varësisht nga vendimi final jo e gjithë energjia e faturuar për këtë qëllim mund të lejohet tu faturohet konsumatorëve, përkatësisht kjo paraqet një procedurë të stërzgjatur dhe vlera e paraparë për arkëtim është diskutabile.
2. Vetëm një vlerë e vogël, afro 20% e energjisë së faturuar në emër të rikthimit të humbjeve inkasohet.

### Përgjigja e ZRRE-së


Për të reflektuar dallimin ndërmjet të hyrave të lejuara ndaj atyre të realizuara gjatë çdo viti bëhet përshtatja e të hyrave përmes faktorit korrigjues (KREV). Në këtë kuptim ZRRE ka bërë përshtatjet e kostove për vitin 2017.

1. Gjatë takimeve me përfaqësuesit e KEDS-it, ZRRE ka dhënë sqarimin se duke qenë se energjia e tillë e pa-faturuar nuk është trajtuar si humbje por është marrë në trajtim në energjinë e hyrë në distribucion (EED) në vlerë prej 4,555GWh atëherë ZRRE ka aplikuar përshtatjen e tillë. Në të kundërtën energjia e tillë do të duhej reflektuar si humbje me qëllim të balancimit të bilancit energjetik të vitit 2016.
2. Lidhur me nivelin e inkasuar, ZRRE dëshiron të theksojë se kjo është çështje e borxhit të keq dhe se niveli i tillë është i lejuar për Furnizuesin.



## 7 Përmbledhja e të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH-së

Pas analizimit të komenteve të KEDS dhe palëve tjera të interesit, ZRRE ka vlerësuar të hyrat e lejuara maksimale për OSSH-në janë në vlerë prej 67.53 milion € si të hyra të nevojshme të cilat i mundësojnë asaj operimin e sigurt dhe efikas. Paraqitja grafike e propozimit të OSSH-së dhe vlerësimit të ZRRE-së është dhënë më poshtë:



Të hyrat e lejuara maksimale janë paraqitur në formë tabelare më poshtë.

**Tabela - Propozimi i MAR të OSSH (KEDS)**

OSSH MAR		SHT10 E lejuar	SHT11 E propozuar
<b>Parametrat e indeksimit</b>			
It	%	14.87%	14.90%
<b>Kosto operative dhe e mirëmbajtjes (OPMct)</b>			
$OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	25.09	23.81
<b>Zhvelrësimi I lejuar</b> $DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	8.75	9.39
<b>Kthimi I lejuar</b> $RTNC_t = RTNC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	14.22	15.99
<b>Obligimet për OS dhe OT</b>			0.39
<b>Humbjet e lejuara (LSSct)</b>			
LSSAt	%	20.63%	18.13%
REUet	GWh	4,027.1	3,962.1
WHEAt	€/MWh	34.1	35.4
Kostoja e lejuar e humbjeve LSSct		28.3	29.7
<b>Azhurnimet</b>			
Të hyrat e parregulluara	€m	-5.33	-5.9
<b>KREV</b>			
KREV	€m	4.13	-4.3
<b>OSSH MAR</b>			
<b>Të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH</b>	<b>€m</b>	<b>76.51</b>	<b>67.53</b>